



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GJERGJ R. KONGOLI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA
NR. 3
TEL: 0682033057

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 235

Nr. koleksioni: 93

Tirane më 15/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

***Akti noterial përbëhet nga 4 fletë**



A2021053630011021599



A2021053630011021599

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "LORALDO" SH.P.K)

Sot, më datë 15.01.2021, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA NR. 3, u paraqit personalisht:

SHITES:

Ardian Avdiaj, atësia Muharem, amësia Hava, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në FIER, me adresë Leon Rei 01490161; Nd. 49; H. 7; Ap. 6; Fier; Fier; 9301; Fier, lindur më 30/03/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036495435 dhe nr. personal H20330076M, .

BLERES:

Armando Pajtoni, atësia Shaban, amësia Fezije, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Gjergj Legisi; Nd. 463; Njësia Administrative Nr. 11; Njesia Bashkiake Nr. 11; 1031; Tiranë, lindur më 11/08/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030863879 dhe nr. personal H90811058K, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "LORALDO" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Kushte Paraprake

Shoqeria "LORALDO" shpk është person juridik shqiptar, regjistruar me datën 25.08.2016, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, filiali Tiranë dhe e pajisur nga kjo zyrë me Çertifikatë Regjistrimi, Person i Tatueshëm, me seli në Tiranë, në adresën :Lagjia Fushe Mezes, Qendra Pajtoni Bussines Center ,kati I 5-te,Rruga Industriale dytesore Tiranë-Durrës, km1, Tirane, me numer unik identifikues NUIS L62025021H.

Shoqeria ka një kapital themeltar prej 100.000 leke (njëqind mijë leke), kapital ky që zotërohet nga dy ortakët e shoqërisë z.Armando Pajtoni ,zotëruar i një kuote me vlerë 50.000 leke e cila përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe z.Ardian Avdiaj i cili zotëron një kuote me vlerë 50.000 leke e cila përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Njeri nga ortakët e shoqërisë z.Ardian Avdiaj për arsye objektive dëshiron të transferojë përmes shitjes kuotën e tij në favor të ortakut tjetër z.Armando Pajtoni ,kuote për të cilën **deklaron dhe garanton se është e lirë nga çdo detyrim në favor të të tretëve ,pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi të.**

Organi Vendimmarres i shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve në kushtet e kuorumit dhe shumicës së cilesuar ,me vendimin e saj nr 1 datë 14.01.2021 ka vendosur transferimin e kuotes që z.Ardian Avdiaj zotëron tek pala blerese z.Armando Pajtoni , në gjendjen që ajo është duke qenë plotësisht dakord dhe duke e miratuar atë pa asnjë rezervë apo pretendim të tashëm apo të ardhshëm.



A2021053630011021599

Pala blerese z.Armando Pajtoni,me vullnetin e saj te lire e te plote ka vendosur te bleje kuoten e z.Ardian Avdiaj me vlere 50.000 leke ,kuote e cila perben 50% te kapitalit te regjistruar te shoqerise" LORALDO"shpk.

Meqe ekzistojne kushtet paraprake me siper, te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate ,palet me vullnetin e tyre te lire e te plote vendosin si me poshte vijon:

NENI 1

OBJEKTI

Me ane te kesaj kontrate ,pala shitese ortaku z.Ardian Avdiaj I cili zoteron 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 leke (pesedhjete mije leke) qe perben 50%(perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise" LORALDO"shpk ,me deshiren dhe vullnetin e tij te plote,te lire e te pavesuar I shet dhe I transferon kuoten e tij me vlere 50.000 leke tek ortaku tjetër I shoqerise, bleresi z.Armando Pajtoni , I cili deklaroi se pranon dhe ble kuoten e z.Ardian Avdiaj me vlere 50.000 leke e cila perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise, te zoteruara nga shitesi e teresisht te lira nga cfaredolloj detyrimi ndaj te treteve ,pa asnje pretendim te tashem apo te ardhshem mbi to .

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë "LORALDO"shpk që Blerësi z.Armando Pajtoni i detyrohet Shitësit , z.Ardian Avdiaj , për blerjen e saj është në vlerë monetare 50.000 leke (pesedhjetemije Leke),cmim I vetem dhe I pandryshueshem per palet ne formen dhe sipas kushteve te ketij neni .

2.2.Ne marreveshje te perbashket palet bien dakord dhe vendosin qe bleresi te kryeje likujdimin total te cmimit te shitjes ne Shumen prej 50.000 leke (pesedhjetete mije leke) , pas nenshkrimit te kontrates se shitjes se kuotes , permes derdhjes ose transferimit bankare ,qe do te kryhet ne llogarine rrjedhese te percaktuar nga pala shitese z.Ardian Avdiaj dhe do te provohet me mandatin bankar perkates I cili do ti bashkelidhet kesaj kontrate si pjese e pandare e saj.

NENI 3

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

NENI 4

KALIMI I PRONESISE

Me nenshkrimin e kontrates se shitjes dhe ekzekutimin te detyrimeve te parashikuara nga kjo kontrate ,per transferimin e kuotes qe z.Ardian Avdiaj zoteron ne shoqeri, me vlere 50.000 leke e cila perben



A2021053630011021599

50% te kapitalit te regjistruar te shoqerise, pala shitese zhvishet plotesisht nga cdo e drejte mbi kuoten dhe pjesen e kapitalit te shoqerise "LORALDO" shpk, objekt kontrate duke I kaluar te gjitha te drejtat dhe detyrimet pa asnje kufizim pronesie mbi kapitalin e shoqerise ne emer te bleresit z.Armando Pajtoni, si pronar I vetem ligjor I tyre (kuotes).

NENI 5

GARANCITE

Shitesi garanton bleresin se kuota objekt kontrate nuk eshte objekt pengu dhe se eshte e lire nga cdo barre apo bllokim apo titull te cdolloj natyre kundrejt te treteve. Nga momenti qe shitesi ka perfituar vleren totale te cmimit te siper permendur humbet cdo te drejte qe rrjedh nga zoterimi I pjesve te kapitalit te shoqerise dhe nga shitja e tyre bleresi behet pronar I vetem dhe I ligjshem I tyre.

Palët deklarojne se jane njohur paraprakisht me gjendjen kontabel te llogarive te shoqerise "LORALDO" shpk sipas aktit te rakordimit te miratuar prej tyre, gjendje me te cilen bleresi deklaroi se eshte dakord dhe e pranon ashtu sic rezulton te jete.

Pala shitesë z.Ardian Avdiaj deklaroi se gjate periudhes qe ka qene ne detyren e administratorit te shoqerise e ka kryer kete funksion me korrektese dhe besnikeri dhe ne interes te shoqerise ne perputhje te plote me ligjin nr 9901 date 14.04.2018 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare", I ndryshuar, statutin e shoqerise dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me kete. Per kete arsye ortaku ne cilesin e pales shitesë I cili ka qene edhe administratori I shoqerise z.Ardian Avdiaj merr persiper te zgjidhe cdo konflikt per cdo lloj objekti ne lidhje me pasojat e veprimeve te tij ne Kohen qe ka administruar shoqerine kundrejt te treteve dhe do te pergjigjet ai ekskluzivisht.

NENI 6

ANEKSET E KONTRATËS

6.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve date 14.01.2021 bashkëlidhur _;
- Nipti dhe Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "LORALDO" Sh.p.k.. datë 15.01.2021
- Faturë e transfertës bankare
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 7

Hyrja ne fuqi dhe ndryshimet ne Kontrate

7.1 Kjo Kontrate hyn ne fuqi me nënshkrimin e saj nga te dy palët.

7.2 Dispozitat e kësaj Kontrate nuk mund te ndryshohen ne asnjëmënyre përveç se me marrëveshje me shkrim te nënshkruar nga Palët.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE



A2021053630011021599

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit. Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët nënshkruese.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Notarinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Ardian Avdiaj




BLERES

Armando Pajtoni

Noter

GJERGJ R. KONGOLI



Shoqeria "LORALDO" shpk

NUIS: L62025021H

Adresa: Tirane Kashar MEZEZ Lagjja Fushe Mezes, Autostrada Tirane Durres KM 1, Qendra Pajtoni Bussines Center, Kati 5, Zona Kadastrale 2679, Pasuria Nr.66/47

VENDIM Nr.1 Date 14.01.2021
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKËVE
TE SHOQËRISË "LORALDO" SHPK

Sot ne Tirane, me date 14.01.2021 (dymije e njezet e nje), ora 11⁰⁰, ne Seline e Shoqerise "LORALDO" SHPK, person juridik shqiptar, , themeluar me date 24/08/2016, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 25/08/2016, pajisur me numer unik identifikimi NUIS L62025021H, me seli qendore ne adresen: Tirane Kashar MEZEZ Lagjja Fushe Mezes, Autostrada Tirane Durres KM 1, Qendra Pajtoni Bussines Center, Kati 5, Zona Kadastrale 2679, Pasuria Nr.66/47, shoqeri e themeluar me nje kapital themeltar te regjistruar prej 100'000 (njëqind mijë) Leke me numër të përgjithshëm të **kuotave 2 (dy)**, u mbledh Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te shoqerise e perbere nga:

1. Ortaku themelues Ardian Avdiaj, shtetas shqiptar, lindur me 30.03.1972, ne Fier , Identifikuar me leternjoftimin nr. 030012461 dhe numer personal H20330076M , madhor me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, Zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 50000 lekë që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues Armando Pajtoni atësia Shaban dhe amësia Fejzie, i datëlindjes 11 Gusht 1979, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: rruga "Gjergj Legisi", banesë private, Nr. 11, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 030863879 dhe numër personal H90811058K. : Zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 50000 lekë që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Rendi I dites se kesaj mbledhje eshte :


- **Doreheqje e z.Ardian Avdiaj nga detyra e administratorit te shoqerise.**
- **Emerimi I administratorit te ri te shoqerise z.Armando Pajtoni .**
- **Transferimi I kuotes se z.Ardian Avdija, me vlere 50% te kapitalit themeltar, permes shitjes ne favor te blesit z.Armando Pajtoni .**
- **Te tjera dhe eventuale**

V E N D O S I

1. Te miratoje doreheqjen e z.Ardian Avdija nga detyra e administratorit te shoqerise ,duke filluar nga data 14 janar 2021, I revokon atij te gjitha kompetencat e dhena dhe e shpall detyren e tij si administrator te shoqerise te perfunduar.

2. Emerimin si administrator te shoqerise "LORALDO" shpk te zotit Armando Pajtoni, , atësia Shaban dhe amësia Fejzie, i datëlindjes 11 Gusht 1979, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: rruga "Gjergj Legisi", banesë private, Nr. 11, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 030863879 dhe numër personal H90811058K. Administratori emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripërteritje. Administratori do te kryej funksionet e tij gjithmone duke iu permbajtur tagrave te parashikuara ne statutin e shoqerise dhe ne ligjin "Ligjin 9901, Date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar.

3. Te miratoje transferimin nepermjet shitjes se kuotes se z.Ardian Avdija e cila perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise ,ne vlere 50.000 leke (pesedhjetë mijë leke) ne favor te blesit z.Armando Pajtoni ,I cili do te behet ortak I vetem me nje kuote ne vleren 100.000 leke ,pra zoterues I 100% te kapitalit themeltar te shoqerise "LORALDO" shpk.



Shoqeria "LORALDO" shpk

NUIS: L62025021H

Adresa: Tirane Kashar MEZEZ Lagjja Fushe Mezes, Autostrada Tirane Durres KM 1, Qendra Pajtoni Bussines Center, Kati 5, Zona Kadastrale 2679, Pasuria Nr.66/47

4. Te hartojë kontratën e shitblerjes së kuotës ku pala shitesë do të jetë z. Ardian Avdija, i cili zotëron 1 kuotë me vlerë 50.000 leke e cila përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe pala blerëse do të jetë zoti Armando Pajtoni, kuotë e cila është e lirë nga çfaredo detyrimi prej të tretëve, pa asnjë pretendim të tashëm e të ardhshëm mbi të.

5. Pas shitjes së kuotës, shoqëria "LORALDO" shpk do të zotërohet nga ortakët i vetëm i shoqërisë z. Armando Pajtoni, i cili do të zotërojë një kuotë me vlerë 100.000 leke (njëqind mijë leke), e cila përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "LORALDO" shpk.

Shoqëria nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten siç kanë qenë.

Ky Vendim do të depozitohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit filiali Tirane me qëllim regjistrimin e tij në përputhje të harmoni të plotë me dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

**ORTAKET E SHOQËRISË
"LORALDO" SHPK**

z. Ardian Avdija

Ardian Avdija



z. Armando Pajtoni

Armando Pajtoni

Banka Amerikane e Investimeve SHA
Kodi I Deges / Branch : 007
Emri I deges / Branch Name :
Autostrada Branch
Adresa e deges / Branch Address :
Rr Dytesore Tirane Durres km1
Godina Pajtoni
Tirane,Albania

Date valuta / Value date : 2021-01-15
Numri I references / Our Ref.number :
0072101500000057

Transferim fondesh i brendshem (Urdher Pagese) / Internal transfer

Kodi I Klientit Debi / Dr. Customer Number : 001471007
Emri I Klientit / Dr. Customer name :
ARMANDO SHABAN PAJTONI

Kodi I Klientit Kredi / Cr. Customer Number : 000028851
Emri I Klientit / Cr Customer name :
ARDIAN AVDIAJ

Numri I Llogarise Debi / Dr Account number : 002369944
IBAN : AL04 2101 1074 0000 0000 0236 9944

Numri I Llogarise Kredi / Cr Account number : 000169309
IBAN : AL06 2102 1080 0000 0000 0016 9309

Monedha / Dr. Currency : ALL
Shuma / Dr. Amount : 50,000.00

Monedha / Cr Currency : ALL
Shuma / Cr Amount : 50,000.00

Kursi I Kembimit / Currency rate : 1.0000

Komisioni / Commission amount : 0.00
Monedha e Komisionit / Commission Currency : ALL

Pershkrimi / Narrative :

ARMANDO PAJTONI KALIM TEK ARDIAN AVDIAJ,PER BLERJE 50% TE KUOTAVE TE SHOQERISE LORALDO SHPK SIPAS

Kodi I perdoruesit / User ID :

Firma e Klientit / Customer signature :

Autorizuesi / Authorizer :

Data, Ora / Date,Time : 2021-01-15 13:58:20

Banka Amerikane e Investimeve SHA
Kodi I Deges / Branch : 007
Emri I deges / Branch Name :
Autostrada Branch
Adresa e deges / Branch Address :
Rr Dytesore Tirane Durrës km1
Godina Pajtoni
Tirane, Albania

Date valuta / Value date : 2021-01-15
Numri I references / Our Ref.number :
0072101500000060

Transferim fondesh i brendshem (Urdher Pagesë) / Internal transfer

Kodi I Klientit Debi / Dr. Customer Number : 001471007
Emri I Klientit / Dr. Customer name :
ARMANDO SHABAN PAJTONI

Kodi I Klientit Kredi / Cr. Customer Number : 000028851
Emri I Klientit / Cr Customer name :
ARDIAN AVDIAJ

Numri I Llogarise Debi / Dr Account number : 002369944
IBAN : AL04 2101 1074 0000 0000 0236 9944

Numri I Llogarise Kredi / Cr Account number : 000169309
IBAN : AL06 2102 1080 0000 0000 0016 9309

Monedha / Dr. Currency : ALL
Shuma / Dr. Amount : 2,500,000.00

Monedha / Cr Currency : ALL
Shuma / Cr Amount : 2,500,000.00

Kursi I Kembimit / Currency rate : 1.0000

Komisioni / Commission amount : 0.00
Monedha e Komisionit / Commission Currency : ALL

Pershkrimi / Narrative :

ARMANDO PAJTONI KALIM TEK ARDIAN AVDIAJ, PER BLERJEN E KUOTAVE TE KOMPANISE SKY INVEST SIPAS KONTR.

Kodi I perdoruesit / User ID :

Firma e Klientit / Customer signature :

Autorizuesi / Authorizer :

Data, Ora / Date, Time : 2021-01-15 14:03:07